



Sistemi shkollor në Bavari

Detyrimi shkollor dhe rregullat zyrtare (Schulpflicht & Stichtagsregelung)

Në Gjermani ka detyrim shkollor. Një fëmijë, i cili mbush moshën 6 vjeç deri në 30 shtator, duhet të fillojë të ndjekë shkollën që prej shtatorit (fillimi i vitit shkollor).

Korridor i pranimit në shkollë (Einschulungskorridor)

Për fëmijët, të cilët nga 1 Korriku deri në 30 Shtator mbushin 6 vjeç, mund të zbatohet korridor i pranimit në shkollë. Këta fëmijë mund të marrin pjesë edhe në regjistrimin në shkollë. Prindërit, përmes këshillimit dhe rekomandimit të shkollës, mund të vendosin nëse fëmija i tyre mund të fillojë shkollën vitin pasues ose një vit më vonë.

Futja e parakohshme në shkollë (Vorzeitige Einschulung)

Fëmijët të cilët vetëm pas 30 Shtatorit i mbushin 6 vjet, mund të futen në shkollë para kohës së përcaktuar. Shkolla kontrollon nëse fëmija mund të ndjekë mësimet siç duhet. Vendimin përfundimtar e merr drejtorja e shkollës.

Shtyrja mbrapa (Zurückstellung)

Fëmijët, të cilët deri më 30 Shtator mbushin 6 vjeç, kanë njëhere të drejtën e shtyrjes së vitit shkollor, pra munden të shkojnë në shkollë 1 vitë më vonë. Fëmijët e lindur nga muaji Janar deri në muajin Qershor, është drejtorja e shkollës ajo që vendos për shtyrjen e vitit shkollor. Prindërit mund të bëjnë një aplikim.

Detyrimi për të ndjekur shkollën pranë vendbanimit (Sprengelpflicht)

Çdo fëmijë duhet të ndjekë shkollën pranë njësisë administrative ku ai banon. Informacionin se në cilën shkollë duhet të shkojë fëmija i juaj e merrni nga kopshti ose nga Administrata Shtetërore e Shkollave Komunale (das Staatliche Schulamt) si dhe nga qyteti i Bambergut.

Kërkesë për t'u regjistruar në një shkollë tjetër (Gastschulantrag)

Prindërit, të cilët për arsye të rëndësishme, duan ta regjistrojnë fëmijën e tyre në një shkollë tjetër, mund të bëjnë një kërkesë: formulari gjendet nëpër shkolla, vendimin e merr qyteti i Bambergut.



Përgatitjet gjatë arsimit parashkollor

Silleni fëmijën tuaj rregullisht në kopsht! (Regelmäßiger Kindergartenbesuch)

Kopshti e përkrahë fëmijën tuaj, për një zhvillim të mirëfillt dhe përgatitje për mësim në shkollë. Në vit të fundit, kopshti e përgatit fëmijën tuaj në mënyrë intensive për shkollën. Veç të tjerash, fëmijët që ndodhen në prag të fillimit të shkollës, vizitojnë së bashku shkollën e tyre të ardhme dhe në të shumtën e rasteve edhe bibliotekën. Kopshti, ku ju çoni fëmijën tuaj, ju mbështet nëse keni pyetje në lidhje me procesin e hyrjes në shkollë. Në rast paqartësish, flisni me edukatoren e fëmijëve tuaj.

Mbrëmje informative për prindërit e fëmijëve të prag të shkollës (Infoabend für Eltern von Vorschulkindern)

Gjatë këtij takimi në kopsht, do të merrni informacione mbi rregulla të rëndësishme ligjore, do të njihni ofertat përgatitore të kopshtit të fëmijëve tuaj dhe do të informoheni në lidhje me orare apo takime të rëndësishme që do t'ju duhet të mbani parasysh.

Përkrahje gjuhësore Gjermanisht (Sprachförderung Deutsch)

Fëmijët kanë mundësi që sipas nevojës të marrin një përkrahje gjuhësore parashkollore. Prindërit, të cilët nuk e përdorin në familje gjuhën gjermane, duhet patjetër mos ta lënë pas dore këtë mundësi. Edhe për fëmijët që nuk janë në kopsht ofrohet kjo mundësi. Pyetni në shkollën tuaj fillore.

Diskutime me prindërit dhe biseda përmbyllëse (Elterngespräche und Abschlussgespräch)

Gjatë gjithë kohës së arsimit parashkollor, mund të informoheni tek edukatorja në lidhje me zhvillimin e fëmijës suaj. Në bisedën përmbyllëse, së bashku me edukatoren, ju do të plotësoni formularin "Informacione për shkollën fillore" (Informationen für die Grundschule), të cilin mund ta sillni me vete kur të regjistroni fëmijën tuaj në shkollë. Shfrytëzoni këtë rast, në mënyrë që përkrahja kundrejt fëmijës suaj të fillojë pa humbur kohë.

KËSHILLË! Vini re afshet në kopsht, të cilat ju informojnë në lidhje me data të rëndësishme si takimi i parë me prindër në shkollë, kontrolli mjekësor apo regjistrimi në shkollë.



Ndihma e prindërve në përgatitjet për shkollë

Edhe ju mund ta përkrahni fëmijën tuaj edhe para fillimit të shkollës!

Të lexuarit dhe të folurit (Lesen & Sprechen)

Lexojini fëmijës suaj tekste në gjermanisht apo në gjuhën tuaj. Trego-jini atij që librat janë diçka shumë e vlefshme dhe përdorini për këtë variantin me çmimin më të favorshëm, bibliotekën. Flisni dhe luani shumë me fëmijën tuaj, lëroni atë t'ju ndihmojë në punët tuaja të përditshme, bëjini shumë pyetje dhe kërkoni që edhe ai t'ju shpjegojë juve diçka. Përveç kësaj përfitoni edhe nga përgatitjet.

Rruga për në shkollë dhe kostot e Autobusit (Schulweg und Buskosten)

Tregojini fëmijës suaj rrugën për në shkollë dhe tregojini atij se si duhet të silltet gjatë kësaj rruge që të mbërrijë i sigurt në shkollë. Nëse rruga për në shkollë është më e gjatë se 2 kilometra, atëherë shpenzimet e udhëtimit me autobus mund të merren përsipër. Për këtë, prindërit mund të bëjnë një aplikim. Këtë formular mund ta merrni kur të regjistroheni në shkollë.

Çanta me dhurata simbolike (Schultüte)

Në Gjermani, është zakon që fëmijët të marrin në fillim të shkollës një çantë të vogël me dhurata simbolike dhe ëmbëlsira nga prindërit ose kumbarët. Shpesh çanta mund të përgatitet në kopsht.

KËSHILLË!

Do të ishte shumë mirë nëse fëmija juaj, kur të fillojë shkolla, të dijë të bëjë gjërat e mëposhtme:

- Të vishet dhe të zhvishet vetë, të shkojë vetë në tualet
- Të mund të përdorë gërrshërët, ngjitësen dhe lapsat
- Të zbatojë rregullat në grup, të dijë të dëgjojë, të arrijë të shprehë dëshirat e tij, të durojë konfliktet, t'u afrohet të tjerëve.
- Të jetë i duruar gjatë lojërave, të mbarojë punët që nis



Regjistrimi në shkollë

Regjistrimi në shkollë bëhet në përgjithësi në mes të marsit. Datën e saktë do ta merrni vesh nga kopshti apo nga shkolla e ardhshme.

Kontrolli mjekësor (Einschulungsuntersuchung)

Kontrolli mjekësor falas nga seksioni i shëndetësisë (Gesundheitsamt) zhvillohet në kopsht ose prindërit marrin ftesë për termin nga departamenti i shëndetësisë Bamberg. Është e domosdoshme që gjatë kontrollit mjekësor të jetë i pranishëm një prind. Për këtë kontroll duhet të sillni me vete dëshminë nga kontrolli mjekësor i fëmijëve U9.

Regjistrimi në shkollë (Anmeldung in der Schule)

Gjatë kësaj dite duhet të jenë të pranishëm edhe prindërit.

Orë mësimi provë (Spielerischer Probeunterricht)

Gjatë regjistrimit në shkollë, fëmija juaj do të jetë pjesëmarrës në një orë provuese. Staf i arsimit dhe mësuesit do të vërejnë fëmijën tuaj, nëse ai/ajo është i/e aftë për të ndjekur mësimin.

Regjistrimi formal

Për regjistrimin në sekretarinë e shkollës ju nevojiten doku-mentat e mëposhtëm

- Çertifikatë lindjeje
- Eventualisht leje qëndrimi/Pasaporta
- Në rast se prindërit jetojnë të ndarë: Dëshmi për të drejtë kujdes tarie
- Vendimi i kontrollit mjekësor të seksionit të shëndetësisë në lidhje me kontrollin e zhvilluar në kopsht
- Vërtetimin për kontroll të mjeku i fëmijëve U9
- Formulari "Informacione për shkollën fillore" (Informationen für die Grundschule) i plotësuar në kopsht me edukatoren

Botues:

Stadt Bamberg
Bildungsbüro
Hauptwachstraße 9
96047 Bamberg

☎ 0951 87-1435 oder -1436

✉ bildungsbuero@stadt.bamberg.de

🌐 www.stadt.bamberg.de/bildungsbuero

Die vorliegende Broschüre ist in Zusammenarbeit mit dem Migrantinnen- und Migrantenbeirat der Stadt Bamberg entstanden.

Sprache vorliegender Broschüre: Albanisch
Diese Broschüre kann kostenlos im Bildungsbüro in folgenden Sprachen bestellt werden: Albanisch, Arabisch, Deutsch, Englisch, Französisch, Rumänisch, Russisch, Türkisch, Ukrainisch

3. Auflage, Stand Juli 2023





Kontakte te dobishme

Oferta arsimore ne rajonin arsimor Bamberg

☎ www.bildungsregion-bamberg.de

→ u.a. Ndermjetesit gjuhesor dhe kulturor „Prinderit-kuptojne-Shkollen“



Amt für soziale Angelegenheiten der Stadt Bamberg

→ Bildung und Teilhabe

☎ 0951 871520, ✉ BUT@stadt.bamberg.de

Bildungsbüro der Stadt Bamberg

☎ 0951 871435/871436, ✉ bildungsbuero@stadt.bamberg.de

☎ www.stadt.bamberg.de/bildungsbuero

Këshilli i migrantëve të qytetit të Bambergut

→ Shërbimi për përkthime

☎ 0951 871870, ✉ mib@stadt.bamberg.de

☎ www.stadt.bamberg.de/Migrantinnen-und-Migrantenbeirat

Seksioni i rinisë Bamberg

→ Hortplätze, Sommerferienprogramm

☎ 0951 871531, ✉ jugendamt@stadt.bamberg.de

☎ www.stadt.bamberg.de/Stadtjugendamt

Administrata shtetërore e shkollave në qytetin e Bambergut

☎ 0951 2974612, ✉ schulamt@stadt.bamberg.de

☎ www.schulamt-bamberg.de

Shërbimi për migrim i Caritasit

☎ 0951 2995720, ✉ fluechtlingsberatung@caritas-bamberg.de

☎ www.caritas-bamberg-forchheim.de/besondere-lebenslagen/fluechtlings--und-integrationsberatung/

Migrationsberatung für Erwachsene und Jugendliche

☎ 0951 868513, ✉ migration@skf-bamberg.de

☎ www.skf-bamberg.de/einrichtungen/hilfe-fuer-migrantinnen

Shërbimi social për migrim i AWO-s

☎ 0951 91700936, ✉ verwaltung-msd@awo-bamberg.de

☎ www.awo-bamberg.de/migration/migrationssozialdienst-msd

Përmbledhje e shkurtër mbi kujdestarinë gjatë pushimit të drekës

☎ www.familienportal-bamberg.de

Biblioteka e qytetit të Bambergut

☎ 0951 9811913, ✉ info@stadtbuecherei-bamberg.de

☎ www.stadtbuecherei-bamberg.de



Udhëzues për prindërit në lidhje me fillimin e shkollës



Fillimi i shkollës do të thotë ndryshim

Viti shkollor nis në mes të shtatorit. Shpesh, me fillimin e shkollës, ndryshon rrjedha e ditës për të gjithë familjen, sidomos për fëmijën tuaj do të ketë shumë ndryshime.

Një ditë normale shkollë (Schulalltag)

Mësimi fillon normalisht në orën 8 dhe për klasën e parë mbaron midis orës 11 dhe 13. Fëmija juaj duhet të jetë në shkollë rreth 15 minuta para se të fillojë mësimi. Fëmijët kanë mesatarisht 23 orë mësimore në javë. Në fillim të vitit shkollor, ju mund të merrni orarin e fëmijëve tuaj.

Pushimet (Schulferien)

Viti shkollor ka gjithsej 14 javë pushim shkollor. Kohën e pushimeve dhe festave do t'ju bëjë të ditur drejtorja e shkollës.

Sëmundje dhe aksidente (Krankheit & Unfall)

Nëse fëmija i juaj është i sëmurë dhe nuk mund të shkojë në shkollë, ju duheni ta informoni shkollën para fillimit të mëimit (ora 8:00). Në rast aksidenti gjatë rrugës për në shkollë ose gjatë qëndrimit në shkollë, nxënësi është i siguruar nga shkolla. Në raste të tilla duhet vetëm të informoni mjekun që bëhet fjalë për një aksident shkollor. Lajmëroni edhe shkollën në lidhje me këtë, pasi atje duhet të shkruhet një raport mbi aksidentin.

Ekskursionet (Ausflüge)

Ekskursionet janë veçanërisht të rëndësishme për motivimin e fëmijës suaj dhe për integrimin e tij në klasë. Për këtë arsye, mos ngurroni ta lejoni atë të marrë pjesë në këto aktivitete shkollore. Në rast nevojë mund të përfiton një mbështetje financiare. Për pyetje të mëtejshme, mund t'i drejtoheni mësuesit apo mësueses së fëmijës suaj.

Detyrat e prindërve

Pavarësi dhe përkrahje (Selbstständigkeit & Unterstützung)

Kur fëmija vjen në shkollë, ai do dhe duhet të bëhet më i pavarur. Megjithatë nuk duhet harruar që për fëmijën tuaj është e mundimshme të përgatitet shpirtërisht për shkollën. Ka gjasa që fëmija juaj të hasë vështirësi për t'u përshtatur. Nëse ndodh kjo, ai do të ketë nevojë për përkrahjen tuaj. Jepini vetes dhe fëmijës suaj kohën e nevojshme për të përballuar këtë ka-pitull të ri të jetës së tij.

Detyrat e shtëpisë (Hausaufgaben)

Fëmija juaj duhet t'i bëjë detyrat e shtëpisë mundësisht në mënyrë të pavarur. Ju mund ta ndihmoni atë shumë nëse e lini t'ju shpjegojë detyrat, edhe pse ndoshta nuk kuptoni shumë nga përmbajtja mësimore e lëndës. Është mirë të tregoni interes dhe të flisni për shkollën me fëmijën tuaj. Mos harroni: Lavdëroni fëmijën tuaj! Nëse ai bën vazhdimisht gabime apo nuk ka dëshirë të mësojë, tregohuni të duruar. Në kujdesin e zgatur të drekës dhe në strehë ditore, fëmijët tuaj marrin ndihmë për detyrat e shtëpisë.

Të mësuarit bashkërisht (Gemeinsames Lernen)

Përpikuni të kaloni sa më shumë kohë duke lexuar dhe llogaritur bashkë me fëmijën tuaj. P.sh. verifikoni së bashku faturat e blerjeve, thojini fëmijës suaj t'ju lexojë diçka nga ndonjë libër apo fletëpalosje ose shkon bashkë në teatër për fëmijë dhe bisedoni rreth tij.

Bashkëpunimi me shkollën (Zusammenarbeit mit der Schule)

Është e rëndësishme të qëndroni në kontakt me shkollën dhe mësuesit. Vizitoni rregullisht takimet me prindër dhe orët e konsultimit. **Për prindërit, të cilët kanë probleme gjuhësore (flasin pak gjermanisht), mund të kërkojnë mbështetjen e ndërmjetësve kulturor dhe gjuhësor ne gjuhën e tyre perkatëse (Projekt „Eltern-verstehen-Schule“) (Projekti „Prindërit-kuptojnë-Shkollën“).** Nëpër shkolla zgjidhet në fillim të çdo viti shkollor këshilli i prindërve. Ju mund të merrni pjesë në këto zgjedhje dhe të angazhoheni për një bashkëpunim sa më të mirë midis shkollës dhe prindërve.

Mbështetje gjatë pasditeve apo pushimeve

Shkolla në Bamberg me orar të zgatur (Ganztagsschule)

Shkollat ditore mësojnë dhe kujdesen për fëmijën tuaj gjatë gjithë ditës (zakonisht deri në ora 16:00). Ju mund ta regjistroni fëmijën tuaj në këtë shkollë edhe nëse nuk banoni në afërsi të saj. Detyrat me shkrim bëhen këtu në shkollë. Ndjekja e shkollës me orar të zgatur është falas, vetëm vakti i drekës duhet paguar nga prindërit. Mbështetja financiare për drekë bëhet e mundur nëpërmjet zyrës për çështje sociale (Amt für soziale Angelegenheiten).

Kujdestari gjatë pushimit të drekës (Mittagsbetreuung)

Pothuajse të gjitha shkollat fillore të Bambergut ofrojnë kujdestari gjatë pushimit të drekës deri të paktën në orën 14:00. Në pushimin e zgatur të drekës (deri në orën 15:30 ose edhe më vonë), fëmija juaj mund të bëjë detyrat e shtëpisë dhe të shfrytëzojë ofertat shitesë për kohën e lirë. Gjatë koës së pushimeve shkollore zakonisht nuk ka kujdestari të pushimit të drekës. Shpenzimet merren përsipër nga prindërit.

Streha ditore (Hort)

Strehat ditore ofrojnë kujdes pas përfundimit të mëimit, deri në ora 17:30. Përveq drekës, detyrave të shtëpisë dhe aktiviteteve të kohës së lirë, streha ditore ofron kujdes edhe gjatë pushimeve shkollore. Shpenzimet për kujdestarinë i ndërmarrin prindërit. Në varësi të rrethanave ekziston gjithashtu mundësia e mbështetjes financiare nga seksioni i rinisë (Jugendamt).

Oferta e kujdestarise dhe kohes se lire gjatë pushimeve

(Betreuungs- und Freizeitangebote in den Ferien)

Programi vjetor "Aventura e pushimeve në Bamberg", për të gjitha pushimet, botohet çdo vit në 1 shkurt. Programi i pushimeve verore, hartuar nga seksioni i rinisë (Jugendamt) botohet në fillim të pushimeve të Rrëshajave. Programet ofrojnë oferta një ditore ose javore gjatë pushimeve. Për arsye të kërkesës së lartë, regjistrimi i menjëhershëm është i nevojshëm.



INFORMACIONE MBI FILLIMIN E SHKOLLËS

- Përgaditja dhe regjistrimi në shkollë
- Këto detyra u takojnë prindërve
- Kujdestari në pasdite apo gjatë pushimeve

Në dispozicion në gjuhët vijuese:

